



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1081/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me apelin e Emine Gashi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Emine Gashi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren në Vendvotimet Nr.2023A/02R, 2023A/03R, 2002A/04R, 2065A/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 16.11.2017, i cili është dërguar përmes dërgesës së postës më datë 10.11.2017 Emine Gashi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Prizren, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me seli në Prishtinë, dega në Prizren me të cilën ka pretenduar se ka pasur manipulim të votave në qendrën e votimit 2023 në Korishë, përkatësisht në vendvotimin 2023A/02R dhe 2023A/03R me të cilën iu është konfirmuar vetëm një votë në FPR kurse vëzhguesi i subjektit politik AAK ia ka konfirmuar 6 vota. Parashtruesja e apelit pretendon se në FPR shihet qartë që kandidatët të njëjtit vend janë shënuar njëherë votat dhe sipër tyre iu kanë konfirmuar të tjera me të cilën thekson se ka dëshmi për këtë parregullsi. Parashtruesja e apelit pretendon se ka pasur manipulime edhe në qendrën e

votimit 2002A/04R në Arbanë me të cilën i mungojnë votat e familjarëve të saj ndërsa në FPR i figurojnë vetëm 2 vota. Po ashtu në qendrën 2065A/01R në Medvec pretendon se i mungojnë votat e të afërmeve të saj dhe në këtë vendvotim nuk i figuron asnjë votë. Apelit ia ka bashkangjitur kopje të formularit të rezultateve për kandidat, formular për plotësim nga koordinatori i vendvotimit dhe informatat nga vëzhguesit. Kërkon nga PZAP-i të bëhet rinumërimi i këtyre vendvotimeve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura paneli e miratoi apelin e apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.* Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.1081/2017 me datë 16.11.2017



Kryesuese e Panelit
Dr.sc. Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.